



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 1001 Faqja web: <http://www.mete.gov.al>

Nr. 4392/Prot.

Tiranë, më 29. 6 . 2011

Drejtuar: **Z. ENGJELL ZEQO**
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I SH.A "KESH"

TIRANË

Lënda: Miratojmë bilancin kontabël dhe shpërndarjen e rezultatit të vitit 2010.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", miratojmë bilancin kontabël dhe shpërndarjen e rezultatit të shoqërisë për vitin 2010.

Fitimi i ushtrimit	15 329 937 000 leke
Rezerve ligjore 5%	766 496 850 leke
Rezerve zhvillimi 95%	14 563 440 150 leke

Rezerva e zhvillimit prej 14 563 440 150 leke , do të kalojë në zmadhim kapitali. Ekspertja e caktuar me urdhrin nr. 361 datë 02.05.2011 të METE-s "Për zmadhimin e kapitalit të Theth -it, të përgatisë raportin e sistemit të rezervave me kapitalin.

MINISTRI

NASIP NAÇO ✓



VENDIM

Nr. 19 DATË 30/05/2011

PËR

MIRATIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË VEPRIMTARISË SË KESH SH.A. PËR VITIN 2010

Në mbështetje neneve 135 dhe 167 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të neneve 8/2, 8/7, 8/8, 8/10, 8/11, 9/7, dhe 16/3 të statutit të KESH sh.a., pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm i KESH sh.a. dhe me raportin e eksperteve të autorizuar, Këshilli Mbikqyrës, në mbledhjen e tij të datës 30/05/2011,

VENDOSI:

1. Miratimin e Pasqyrave Financiare të veprimtarisë së KESH sh.a. për vitin 2010, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Pasqyrat Financiare të veprimtarisë së KESH sh.a. për vitin 2010, së bashku me këtë vendim të Këshillit Mbikqyrës, t'i paraqiten për miratim përfundimtar Asamblesë së Aksionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Ilirjan MUHO

Jorgaq KAÇANI – Nënkryetar

Zef PREÇI – Anëtar

Agim BREGASI – Anëtar

Agim PASKALI – Anëtar

Dorjan TELITI – Anëtar

RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

Drejtuar:

Ministrise se Ekonomise, Tregetise dhe Energjetikes

Keshillit Mbikqyres te shoqerise "K.E.SH" Sh.A.

Te nderuar zoterinj !

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te "K.E.SH" sh.a. (Grupi) qe perfshijne :

- o bilancin me 31 Dhjetor 2010
- o pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve
- o pasqyren e ndryshimeve ne kapitalin e vet
- o pasqyren e flukseve te parave per vitin ushtrimor te mbyllur me 31 Dhjetor 2010

si dhe nje permbledhje te politikave kontabel kryesore dhe shenime te tjera shpjeguese.


Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Grupit eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Nderkometare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofte nga mashtrime apo pasaktesira; perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave te duhura kontabel dhe berjen e vleresimeve kontabel qe jane te pershtatshme per rrethanat.

Pergjegjesia e Auditorit

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tone. Ne kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te perfojme siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk kane gabime materiale.

Auditimi perfshin procedura per te marre prova auditimi per vlerat dhe paraqitjet ne pasqyrat financiare.

The bottom right of the page contains several handwritten signatures in blue ink. There are also some faint, illegible stamps or markings. The signatures appear to be of various individuals, possibly representing the audit firm or the company being audited.

Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, perfshire dhe vleresimin e riskut te egzistences se gabimeve materiale ne pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktesira. Ne berjen e ketyre vleresimeve, auditori konsideron kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare, por jo per qellimin e shprehjes se nje opinionit mbi efektetiviteten e kontrollit te brendshem te entitetit. Nje auditim perfshin gjithashtu vleresimin per pershtatshmerine e parimeve kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e vleresimeve kryesore te bera nga drejtuesit, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidencat e auditimit qe kemi marre ofrojne baza te arsyeshme per dhenien e opinionit te auditimit.

Arsyet per dhenien e opinionit me rezerve

1. Grupi gjate kalimit te raportimit te tij financiar sipas IFRS-ve zgjodhi te vleresoje nje pjese te rendesishme te Aktiveve Afategjata materiale(AAM) me vleren e tyre te drejte bazuar mbi nje vleresim te kryer me 31 dhjetor 2003, dhe ta perdore ate vlere si baze per koston e gjykuar sipas IFRS-ve ne daten e atij vleresimi. Ne vijim te ketij rivleresimi, ka disa mangesi dhe pasiguri te cilat ndikojne ne raportimin financiar si me poshte :

Pas rivleresimit jane bere korrigjime te tjera ne tepricat e celjes te AAM, per shkak te te cilave Grupi nuk ishte ne gjendje ta na siguronte nje rakordim te AAM me 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009, sic jane rregjistruar ne librat kontabel, me tabelat e rivleresimit te siguruara nga ndonje vleresues, apo me ndonje analize tjetere.

Faktori i vjeterimit ekonomik i perdorur per AAM ne daten e rivleresimit eshte i njejte per te gjitha asetet 75%, pa bere diferencime sipas specifikave te tyre.


Nje test per renien ne vlere te AAM eshte kryer me 31 dhjetor 2007 dhe humbja nga renia ne vlere u njoh ne vitin 2007, veprim ky i cili sipas Vendimit te Ministrise se Ekonomise, Tregetise dhe Energjitikes u kthye dhe eshte pasqyruar ne menyre retrospektive permes fitimeve te mbartura, megjithese Grupi nuk ka bere ndonje vleresim per te percaktuar nese AAM kane humbje nga renia ne vlere me 31 dhjetor 2010.

Ne keto kushte nuk mund te percaktojme se cfare veprimi rregullues mund te ishte i nevojshem per tu kryer ne pasqyrat financiare te « K.E.Sh » sh.a.

2. Shoqeria nuk ka llogaritur gjate vitit 2010 provizione per mosarketimin e klienteve te saj qe rrjedhin nga mosarketimi i klienteve per konsumin e energjise elektrike.

Ne keto kushte nuk mund te percaktojme se cfare veprimi rregullues mund te ishte i nevojshem per tu kryer ne lidhje me pasqyrimin e kerkesave per arketim, si dhe me testimin e shumes se zhvleresimit te kerkesave te arketueshme per periudhen qe mbyllet me 31 Dhjetor 2010.

3. Ne pasqyrat financiare te Grupit vleresimi i huadhenieve nuk eshte bere me vleren e drejte, edhe pse huadheniet jane objekt i SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja. Po keshtu pasqyrimi ne pasqyrat financiare i kredive te marra (me vleren kontabel) nuk ishin mbeshtetur ne evidence te mjaftueshme dhe te pershtatshme.



Per me teper shenimet plotesuese per shumat e raportuara per rrezikun valutor, rrezikun e normave te interesit, rrezikun e likuiditetit si dhe vleren e drejte (per kredite e marra) nuk ishin mbeshtetur ne evidence te plote.

Ne keto kushte nuk mund te percaktojme se cfare veprimi rregullues mund te ishte i nevojshem per tu kryer ne pasqyrat financiare te konsoliduara.

Opinion

Sipas opinionit tone, me perjashtim te efekteve te rregullimeve neqofte se do te kishte ndonje te tille, qe mund te ishin percaktuar te nevojshme per tu bindur persa i perket ceshtjeve te trajtuara ne pikat e mesiperme (1-3), pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te "K.E.SH." sh.a. me 31 Dhjetor 2010 dhe te rezultatit te saj financiar ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standardet Nderkombare te Raportimit Financiar.

Ekspertet Kontabel te Rregjistruar

Theodhora Gjoshaj



Nexhmije Çela

[Handwritten signature]


Diana Ylli (Golemi)




Fatime Alliu



Mimoza Çibuku



Elza Balla



Ajeta Shkëmbi



Eneida Rrahmani



Kristaq Ndini



Lavderim Fusha



Neshat Mazaj



Tirane, me 28 Maj 2011

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE - KESH Sh.a.

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

01 Janar - 31 Dhjetor 2010

J 61817005 F

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
31 DHJETOR 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

		Viti i mbyllur më Shënime 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	41,049,441	42,498,720
Aktive afatgjata jomateriale		4,603	162
Aktive financiare	9	24,523,324	22,061,534
		65,577,367	64,560,417
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	8	2,857,509	2,986,049
Aktive financiare	9	2,604,668	2,313,131
Llogari të arkëtueshme e të tjera	7	30,017,583	24,212,418
Tatimi i parapaguar mbi fitimin		1,463	553,878
Parapagime dhe shpenzime të shtyra			7,620
Mjete monetare në arkë e bankë	10	2,429,844	1,110,795
		37,911,068	31,183,890
Totali i aktiveve		103,488,435	95,744,308
KAPITALI			
Kapitali aksioner dhe rezervat			
Kapitali aksioner	11	1,551,778	5,844,368
Reduktim i paregjistruar kapitali	11	(4,000)	(3,987,335)
Rezerva të tjera		18,681,211	15,658,043
Rezerva ligjore		933,717	806,865
Humbje të mbartura			(815,861)
Fitimi (humbja) e vitit		15,329,937	3,352,876
Totali i kapitalit		36,492,642	20,858,956
DETYRIME			
Detyrime afatgjata			
Kredi dhe hua	13	38,925,578	35,782,653
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	14	858,510	885,167
Grante qeveritare	15	95,326	2,118,430
Detyrime të tjera afat-gjata	12	917,284	-
		40,796,699	38,786,250
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme dhe të tjera	12	13,064,372	13,038,256
Kredi dhe hua	13	13,134,722	23,060,846
		26,199,095	36,099,102
Totali i detyrimeve		66,995,793	74,885,352
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		103,488,435	95,744,308

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 19 Maj 2011 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Z. Engjëll Zeqo

Z. Artur Kurti

Zj. Ani Spahiu

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Operacionet e vijueshëm			
Të ardhura	16	25,722,538	10,726,452
Të ardhura të tjera	17	313,147	476,470
Materiale të para dhe të konsumueshme		(153,202)	(128,391)
Ndryshim gjendje i energjisë			212,086
Blerje energjie	22	(1,118,307)	(872,752)
Shpenzime personeli	18	(1,249,896)	(1,111,920)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(782,056)	(766,174)
Humbje nga rënia në vlerë			-
Shpenzime të tjera	19	(3,105,991)	(668,770)
Fitimi operativ		19,626,233	7,867,001
Të ardhura financiare	20	521,135	957,305
Shpenzime financiare	20	(3,048,544)	(5,401,629)
Shpenzime financiare neto		(2,527,409)	(4,444,324)
Fitimi para tatimit		17,098,824	3,422,676
Kreditim i tatimit mbi fitimin	21	26,657	6,820
Shpenzime tatim fitimi		(1,795,544)	(76,620)
Fitimi neto i periudhës nga operacionet e vijueshëm		15,329,937	3,352,876
Operacionet jo të vijueshëm			
Fitimi neto i periudhës nga operacionet jo të vijueshëm		-	-
Fitimi neto i periudhës		15,329,937	3,352,876
Shpërndarje e Fitimit:			
Aksionerë të Shoqërisë		15,329,937	3,352,876
		15,329,937	3,352,876

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 19 Maj 2011 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Z. Engjëll Zeqo

Z. Artur Kurti

Zj. Ani Spahiu



KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2010

	Aksionerët e Shoqërisë						Interesi i pakicës	Totali i kapitalit
	Kapitali aksioner	Shtesë kapitali e paregjistruar	Reduktim i paregjistruar kapitali	Rezerva të tjera	Rezerva ligjore	Fitim/ (Humbje) të mbartura		
<i>(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)</i>								
Gjendja më 1 Janar 2009	20,735,161	8,085,331	(30,273,312)	15,843,609	15,360,077	(12,059,220)	27,000	17,718,646
Të ardhura neto për periudhën	-	-	-	-	-	3,352,876	-	3,352,876
Sistemim i kapitalit	(14,890,793)	(8,085,331)	22,976,124	-	-	-	-	-
Transferime tek rezervat	-	-	-	(185,566)	-	-	-	(185,566)
Tjetër (lutemi shpjegoni më poshtë)		-	3,309,335	-	(14,553,212)	11,243,359	(27,000)	(27,000)
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	5,844,368	-	(3,987,336)	15,658,043	806,865	2,537,015	-	20,858,956
Të ardhura neto për periudhën						15,329,937		15,329,937
Shperndarja e rezultatit te vitit 2009				2,156,463	126,851	(2,283,314)		-
Divident i paguar						(253,702)		(253,702)
Regjistrim ne QKR i uljes se Kapitalit	(3,983,336)		3,983,336					-
Ulje Kapitali per asetet e Tec-eve	(309,254)			(1)				(309,255)
Transferime ne rezerva nga rivleresimi				882,614				882,614
Transferime tek rezervat				(15,908)				(15,908)
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,551,778	-	(4,000)	18,681,211	933,717	15,329,937		36,492,642

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 19 Maj 2011 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Z. Engjëll Zeqo

Drejtore i Departamentit Ekonomik

Z. Artur Kurti

Shefi i Sektorit të Kontabilitetit

Zj. Ani Spahiu

Shënimet shpjeguese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.
PASQYRA E KONSOLIDUARA E FLUKSEVE MONETARE PER VITIN E
MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

Shënime Viti i mbyllur më Viti i mbyllur më
31 Dhjetor 2010 31 Dhjetor 2009

Flukset e parasë nga aktivitetet operative

Flukset e parasë përdorur në aktivitetet operative	23	12,927,170	1,285,411
Interesa të paguara		(1,734,908)	(2,781,052)
Tatimi i paguar mbi fitimin			-
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet operative		11,192,262	(1,495,641)

Flukset e parasë nga aktivitetet investuese

Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(1,579,285)	(9,085,548)
Hua dhënë palëve të treta		(3,533,995)	(2,844,012)
Shlyerje të kredive nga palë të treta		2,551,391	1,282,855
Interesa të arkëtuara		412,847	880,824
Flukset neto të parasë përdorur në aktivitetet investuese		(2,149,042)	(9,765,881)

Flukset e parasë nga aktivitetet financuese

Të ardhura nga huamarrjet		(6,161,138)	9,784,018
Shlyerje e huamarrjeve		(9,464,815)	(3,176,098)
Të ardhura nga grantet		2,926	5,875
Flukset neto të parasë nga aktivitetet financuese		(3,300,751)	6,613,795

Rritja (+)/rënia(-) neto e mjeteve monetare

Mjete monetare në fillim të periudhës kontabël		(13,161,325)	(8,513,598)
Mjete monetare në fund të periudhës kontabël	10	(7,418,856)	(13,161,325)

Pasqyrat financiare të konsoliduara u aprovuan më 19 Maj 2011 dhe u firmosën si më poshtë:

Administratori

Z. Engjëll Zeqo

Drejtor i Departamentit
Ekonomik

Z. Artur Kurri

Shefi i Sektorit të
Kontabilitetit

Zj. Ani Spahiu

1. Informacion i përgjithshëm

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a dhe Shoqëritë e kontrolluara prej saj (së bashku "KESH" ose "Grupi") u themelua si një shoqëri anonime me aksione më 31 Dhjetor 1994. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë zotëron plotësisht kapitalin aksioner të KESH-it.

Më 31 Dhjetor 2010, Grupi zotëronte kapitalin aksioner të 'KESH Security SHRSF' Sh.a. ("KESH Security") dhe "Termocentrali Vlorë" Sh.a. ("TEC Vlorë"). KESH Security u themelua më 7 Prill 2008 bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Grupit dhe është e përfshirë në sigurimin e shërbimeve të ruajtjes për Grupin. TEC Vlorë u regjistrua si një shoqëri tërësisht e kontrolluar nga Grupi në Dhjetor 2007, dhe veprimtaria kryesore e tij është prodhimi i energjisë.

KESH-i aktualisht përbëhet nga 7 njësi prodhuese hidro-energjetike dhe termo, KESH Security, TEC Vlorë dhe Administrata Qendrore. Shoqëria e ka adresën zyrtare në Shqipëri. Adresa e zyrës së saj të regjistruar është Blloku Vasil Shanto, Kutia postare 259/1, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(b) Ndryshimet në politikat kontabël

Standardet e reja dhe të rishikuara të adoptuara nga Shoqëria

Shoqëria ka adoptuar SNRF-të e reja dhe të rishikuara që janë paraqitur më poshtë që nga 1 Janar 2009:

- **SNRF 7 'Instrumentat Financiarë – Dhënie Informacioni' (I rishikuar)** – në fuqi nga 1 Janari 2009. Standardi i rishikuar kërkon informacion shtesë për matjen me vlerën e drejtë dhe riskun e likuiditetit. Mënyra e matjes me vlerë të drejtë duhet të analizohet në shënimet shpjeguese sipas burimeve të kontributeve duke përdorur hierarkinë me tre nivele të vlerës së drejtë, sipas klasave, për të gjithë instrumentat financiarë të njohur me vlerë të drejtë. Për më tepër, kërkohet informacion për rakordimin mes gjendjes në fillim dhe gjendjes në fund për nivelin e tretë të matjes me vlerë të drejtë, si dhe për transferimet e rëndësishme midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë. Amendimet qartësojnë kërkesat për shënimet në lidhje me riskun e likuiditetit përsa i përket transaksioneve me derivativët dhe aktivet e përdorura për manaxhimin e likuiditetit. Informacioni shpjegues për vlerën e drejtë dhe riskun e likuiditetit paraqitet në Shënimin nr.30 dhe nuk ndikohet në mënyrë të rëndësishme nga rishikimi i standardit.
- **SNK 1 (rishikuar), 'Paraqitja e pasqyrave financiare'** - në fuqi nga 1 Janar 2009. Standardi i rishikuar ndan ndryshimet e pronarëve dhe të jo-pronarëve në kapital. Pasqyra e ndryshimit në kapital përfshin vetëm detajet e transaksioneve me pronarët, ndërsa ndryshimet në kapitalin jo-pronar, paraqiten në rakordimin e çdo elementi të kapitalit. Standardi prezanton dhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse: ku paraqiten të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura si në një pasqyrë të vetme, ashtu dhe në dy pasqyra të lidhura më njëra-tjetrën. Shoqëria ka zgjedhur të paraqesë një pasqyrë të vetme të të ardhurave gjithëpërfshirëse. Informacioni krahasues është riparaqitur konform standardit të ri. Duke qenë se ndryshimi në politikën kontabël ndikon vetëm mbi aspekte të paraqitjes, nuk ka ndikim mbi fitimin për aksion.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(b) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ndryshimet e kërkesave për dhënie informacioni.

Standartet e reja, amendimet e standarteve dhe interpretimeve të paraqitura më poshtë, janë të detyrueshme për herë të parë për pasqyrat financiare për vitin që fillon me 1 Janar 2009, por nuk janë aktualisht të rëndësishme për Shoqërinë.

- SNRF 1 Adoptimi i Standardeve Ndërkombetare të Raportimit Financiar për herë të parë dhe SNK 27 Pasqyrat financiare të rishikuara dhe individuale (Amenduar)
- SNRF 2 Pagesat e Bazuar në aksione: Kushtet dhe Anullimet e Kushtëzimeve
- SNRF 8 Segmentet e Shfrytëzimit
- SNK 23 Kostot e Huamarrjes (Rishikuar)
- SNK 32 Instrumentat financiarë: paraqitja dhe SNK 1 Instrumentat financiarë të kthyeshëm dhe detyrimet që lindin nga likuidimet
- KIRFN 9 Rivlerësimi i instrumentave derivativë të perfshire dhe SNK 39 Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja
- KIRFN 13 Programi i besnikërise ndaj klientit
- KIRFN 15 Marrëveshjet për ndërtimin e pasurive të paluajtshme
- KIRFN 16 Mbrojtjet e investimve neto në operacionet e huaja
- KIRFN 18 Transferimi i aktiveve nga klientët
- BSNK Projekti vjetor për përmirësim nga Maj 2008.

Në Maj të 2008 BSNK përfundoi paketën e parë të ndryshimeve në standardet e saj, kryesisht me qëllim largimin e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit. Datat efektive të përmirësimeve janë të ndryshme dhe më e hershme është ajo për vitin financiar duke filluar nga data 1 Janar 2009.

- **SNRF 5 Aktivët Afatgjatë që mbahen për Shitje dhe Operacionet Jo të vijueshme.**
Amendimi sqaron se të gjitha pasuritë e një dege dhe detyrimet, janë klasifikuar si të mbajtur për shitje, sipas SNRF 5, edhe në rastin kur subjekti do të mbajë një interes për jo-kontrollin në degë pas shitjes.
- **SNRF 7 Instrumentet financiare: Shënimet shpjeguese**
Ky amendim heq referencën 'të ardhurat totale të interesit' si pjesë përbërëse e shpenzimeve financiare.
- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare**
Ky amendim sqaron se aktivet dhe detyrimet e klasifikuara si të mbajtura për tregti në përputhje me SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja nuk janë klasifikuar automatikisht si afatshkurtra në bilanc.
- **SNK 8 Politikat Kontabile, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet**
Ky amendim sqaron se vetëm udhëzimi i implementimit që është një pjesë integrale e SNRF është i detyrueshëm kur zgjedhen politikat kontabile.
- **SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**
Ky amendim sqaron se dividendët e deklaruar pas përfundimit të periudhës raportuese nuk janë detyrime.
- **SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale**
Ky amendim sqaron se aktivet afatgjatë materiale të mbajtura për dhënie me qira, që shiten në mënyrë rutinë gjatë aktivitetit të zakonshëm të biznesit pas marrjes me qira, transferohen në inventar kur nuk janë me qira dhe janë mbajtur për shitje.
Të ardhurat nga shitja paraqiten më pas si të ardhura. SNK 7 Pasqyra e fluksit të parave është rishikuar gjithashtu, që të kërkojë që pagesat e parave për të prodhuar ose përfutur aktive të tilla do të klasifikohen si flukse të parasë nga aktivitetet operative. Flukset monetare hyrëse nga qiratë dhe shitja pasuese e pasurive të tilla klasifikohen gjithashtu si flukse të parasë nga aktivitetet operative.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(b) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

- **SNK 18 Të ardhurat**

Ky amendim zëvendëson termin "kostot direkte 'me' kostot e transaksionit" siç përcaktohet në SNK 39.

- **SNK 19 Përfitimet e punonjësve**

Ky amendim shqyrton përkufizimet e "kostot e shërbimeve të shkuara," kthimi mbi aktivet e skemës' dhe përfitime të punonjësve ' afatshkurtra 'dhe' të tjera afatgjata, të përqëndrohen në momentin kohor në të cilin detyrimi duhet të shlyhet.

- **SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmën Qeveritare**

Kreditë e dhëna pa apo me norma interesi më të ulëta se ato të tregut nuk bëjnë përjashtim nga kërkesa për të ngarkuar interes. Interesi do të llogaritet për kreditë e dhëna me norma interesi më të ulëta se ato të tregut, duke qenë në përputhje me SNK 39. Diferenca ndërmjet shumës së marrë dhe shumës së zbritur kontabilizohet si një grant i qeverisë. Të aplikohet prospektivisht SNK 39 për kreditë qeveritare marrë më ose pas dates 1 Janar 2009.

- **SNK 23 Kostot e huamarrjes**

Amendimi rishikon përkufizimin e shpenzimeve të huamarrjes për të konsoliduar në një llojet e njëjësive që janë konsideruar si komponentët e 'kostove të huamarrjes ' - shpenzimi i interesit llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit siç përshkruhet në SNK 39.

- **SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta**

Kur një njësi mëmë e konsideron një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39 në pasqyrat e saj të veçanta financiare, ky trajtim vazhdon edhe kur shoqëria e kontrolluar është klasifikuar si e mbajtur për shitje.

- **SNK 28 Investime në Pjesëmarrje**

Ky interpretim sqaron se (i) në qoftë se një pjesëmarrje është konsideruar me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 39, vetëm kërkesat e SNK 28, për të treguar natyrën dhe shtrirjen e kufizimeve të rëndësishme në aftësinë e pjesëmarrjes për të transferuar fonde te njësia, në formën e parave ose shlyerjen e kredive; zbatohen dhe (ii) një investim në një ortakëri është një aset i vetëm me qëllimin e kryerjes së testit të zhvlerësimit - duke përfshirë çdo anulim të zhvlerësimit. Prandaj, çdo zhvlerësim nuk është i ndarë në mënyrë të veçantë në emrin e mirë të përfshirë në bilancin e investimeve dhe çdo zhvlerësim anulohet, nëse shuma e rikuperueshme e pjesëmarrjes rritet.

- **SNK 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste**

Ky amendim rishikon referencën lidhur me përjashtimin për të matur aktivet dhe detyrimet me kosto historike, dhe thekson si shembull aktivet afatgjata materiale, në vend që të lihet të kuptohet se është një listë përfundimtare.

- **SNK 31 Interesi në Sipërmarrjet e Përbashkëta**

Ky amendim sqaron se në qoftë se një sipërmarrje e përbashkët është konsideruar me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 39, aplikohen vetëm kërkesat e SNK 31 që lidhen me angazhimet e sipërmarrjes dhe sipërmarrjet e përbashkëta, si dhe përmbledhjen e informacionit financiar në lidhje me asetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet .

- **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm**

Ky amendim sqaron se fitimet për çdo aksion janë paraqitur në raportet e ndërmjetme financiare, nëse një entitet është brenda fushëveprimit të SNK 33.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(b) Ndryshimet në politikat kontabël (Vazhdim)

- **SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve**

Ky amendim sqaron se kur flukset e skontuara të parave janë përdorur për vlerësimin e "vlerës së drejtë minus kostot e shitjes", të njëjtat shpjegime kërkohen si kur flukset e skontuara të parave janë përdorur për vlerësimin e "vlerës në përdorim".

- **SNK 38 Aktivitet Jomateriale**

Shpenzimet për reklama dhe aktivitete promovuese njihen si shpenzim kur njësia ose ka të drejtë përdorimi të të mirave ose ka përfutur shërbimet.

Nje parapagim mund të njihet vetëm në rast se pagesa është bërë në avancë për të fituar të drejtën e përdorimit të të mirave ose marrjes së shërbimeve.

- **SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja**

Sqaron se ndryshimet në lidhje me derivatët - veçanërisht derivatet e percaktuar apo ri-caktuar si instrumente mbrojtjeje pas njohjes fillestare - nuk janë riklasifikime. Kështu, një derivat mund të hiqet nga, ose të përfshihet në klasifikimin, 'vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes' pas njohjes fillestare. Në mënyrë të ngjashme, kur mjetet financiare janë riklasifikuar si rezultat i ndryshimit nga një kompani sigurimesh i politikës së saj kontabël në përputhje me paragrafin 45 të SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve, ky është një ndryshim në rrethana, dhe jo një riklasifikim.

Kërkon përdorimin e normës së interesit efektiv të rishikuar (në vend të normave origjinale efektive të interesit) kur rimatet një instrument borxhi pas përfundimit të kontabilitetit të mbrojtjes me vlerë n e drejtë.

- **SNK 40 Aktivitet materiale afatgjata të investuara**

Ndryshon qëllimin (dhe qëllimin e SNK 16) i tillë që prona që është duke u ndërtuar ose zhvilluar për përdorim në të ardhmen si një pronë për investim të klasifikohet si aktiv material afatgjatë për investim. Nëse një njësi nuk është në gjendje të përcaktojë vlerën e drejtë të një prone në ndërtim, por pret të jetë në gjendje të përcaktojë vlerën e saj të drejtë në përfundim, investimi në ndërtim e sipër do të matet me kosto deri sa të mund të përcaktohet vlera e drejtë ose kur ndërtimi të ketë përfunduar.

Sqaron se vlera e mbetur e aktivitet material afatgjatë të marrë me qira është vlerësimi i marrë plus ndonjë detyrim i njohur.

(c) Baza e matjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë
- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet biologjike janë matur me vlerë të drejtë minus kostot e vlerësuar në pikën e shitjes
- pronat e mbajtura për qëllime investimi janë matur me vlerë të drejtë
- detyrimet nga marrëveshjet për pagesa të bazuara në aksione që shlyhen në mjete monetare janë matur me vlerë të drejtë.

2. Bazat e përgatitjes (Vazhdim)

(d) Bazat e konsolidimit

Filialet janë të gjitha njësitë ekonomike (duke përfshirë njësitë ekonomike për qëllime të veçanta) ndaj të cilave Grupi ka fuqi për të drejtuar politikën e përgjithshme financiare dhe operacionale çka zakonisht shoqërohet me zotërim të më shumë se gjysmës së aksioneve me të drejtë vote. Ekzistenca dhe ndikimi i të drejtave potenciale të ushtrimit të votës që janë aktualisht të ushtrueshme apo të konvertueshme merren në konsideratë kur vlerësohet kontrolli i grupit ndaj një njësie tjetër ekonomike. Filialet janë plotësisht të konsoliduara prej datës në të cilën kontrolli i transferohet Grupit. Ato nuk përfshihen në konsolidim në momentin që kontrolli ndërpritet.

Për regjistrimin në kontabilitet të blerjes nga Grupi të filialeve është përdorur metoda e blerjes. Kostoja e një blerjeje matet si vlera e drejtë e aktiveve të dhëna, instrumenteve të emetuar të kapitalit dhe detyrimeve të ndodhura ose të marra përsipër në datën e shkëmbimit, plus kostot e lidhura direkt me blerjen. Aktivet e blera, detyrimet dhe detyrimet e kushtëzuara të identifikueshme që merren përsipër në një kombinim biznesesh maten fillimisht me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interesi të pakicës. Teprica e kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të pjesës së Grupit të aktiveve neto të identifikueshme të blera regjistrohet si emri i mirë. Nëse kostoja e blerjes është më e vogël se vlera e drejtë e aktiveve neto të filialit të blerë, diferenca njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Transaksionet brenda Grupit, balancat dhe fitimet e përealizuara nga transaksionet midis Shoqërive të Grupit, eliminohen. Humbjet e përealizuara gjithashtu eliminohen, por konsiderohen si tregues i rënies në vlerë të aktivitetit të transferuar. Politikën kontabël të filialeve janë ndryshuar kur është gjykuar e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri me politikën e adoptuar nga Grupi

(e) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara paraqiten në mijë Lekë ('000 LEK), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Grupit. Informacioni financiar i paraqitur në Lekë është përafëruar në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

(f) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykimet kritike për zbatimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm mbi shumat e regjistruara në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël paraqitur më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra të konsoliduara financiare dhe janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga njësitë e Grupit.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën përkatëse funksionale duke përdorur kurset e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare të shprehur në monedha të huaja në datën e raportimit rikonvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kurset e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së përcaktimit të vlerës së drejtë.

Kurset kryesore të këmbimit ndaj Lekut janë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
1 EUR	138.77 Lek	137.96 Lek
1 USD	104.00 Lek	95.81 Lek
1 CHF	110.98 Lek	93.04 Lek
100 YEN	127.90 Lek	103.72 Lek

(b) Aktivitet afatgjata materiale

Tokat dhe ndërtesat përfshijnë kryesisht impiante energjetike dhe ndërtesa zyrash. Te gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto pakësuar më pas me zhvlerësimin dhe rënien në vlerë, përveç tokës, e cila paraqitet me kosto pakësuar me rënien në vlerë. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë, çdo kosto tjetër të lidhur direkt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për përdorimin e synuar, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Programet e blera që janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjeve me të cilat lidhen kapitalizohen si pjesë e atyre pajisjeve. Drejtimi ka aplikuar vlerën e drejtë si bazë për koston e supozuar për disa zëra të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara kur Shoqëria bëri kalimin drejt SNRF-ve më 1 Janar 2006.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Grupi do të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese dhe kosto e saj mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Zhvlerësimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të zhvlerësimit për shpërndarjen e kostos së aktivitet minus vlerën e tij të mbetur përgjatë jetës së tij të dobishme si vijon :

– ndërtesa	15-40 vjet
– makineri dhe pajisje	5-45 vjet
– mjete transporti	3-20 vjet
– orendi, instalime dhe pajisje	5-8 vjet

Toka, përmirësimet e tokës, ndërtimet në proces dhe parapagimet ndaj furnitorëve nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar çmimin e shitjes me vlerën kontabël. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet jomateriale

- *Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit*

Shpenzimet e kryera për zhvillimin e projekteve janë regjistruar si aktive të paprekshme. Sipas SNK 38 kjo lejohet vetëm nëse është e mundshme që projekti do të ketë sukses, duke konsideruar mundësinë komerciale dhe teknologjike, dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme.

(d) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe tatimit të shtyrë aktiv rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie në vlerë. Nëse një tregues i tillë ekziston atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël është më e madhe sesa vlera e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e madhe mes vlerës në përdorim dhe vlerës së tregut minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontoen me një normë skontimi para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudha të mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë tregues rreth zvogëlimit ose eliminimit të humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rikthehet nëse ka pasur një ndryshim në treguesit e përdorur për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret vetëm në masën në të cilën vlera kontabël e aktivit nuk e kalon vlerën e aktivit që duhej të përcaktohej, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, nëse asnjë humbje nga rënia në vlerë nuk do të ishte njohur.

(e) Rënia në vlerë e aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet që ka pësuar një rënie në vlerë nëse ka evidencë objektive që tregon se një ose disa ngjarje kanë pasur efekt negative mbi flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi.

Një humbje nga rënia në vlerë në lidhje me një aktiv financiar matur me kosto të amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën origjinale efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për rënie në vlerë mbi baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme në lidhje me rreziqet kredituese. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pasi humbja është njohur. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(f) Inventarët

Inventarët maten me shumën më të vogël midis koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve bazohet në parimin hyrje e parë, dalje e parë (FIFO) dhe përfshin shpenzime të ndodhura në blerjen e inventarëve, kostot e prodhimit dhe të transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura gjatë transferimit të tyre në vendodhjen dhe konditat ekzistuese.

Në rastin e inventarëve të prodhuar dhe punimeve në proces, kostoja përfshin një shpërndarje të caktuar të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit duke u bazuar në kapacitetin normal të aktivitetit.

Kostoja e inventarit mund të përfshijë edhe transferime nga kapitali të çdo fitimi apo humbjeje nga mbrojtje të kualifikueshme të flukseve monetare nga blerjet në monedhë të huaj të inventarit.

Vlera e realizueshme neto është është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit duke zbritur shpenzimet e vlerësuara të përfundimit të shitjes.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Instrumentat financiarë

Grupi zotëron vetëm instrumenta financiarë jo-derivativë, duke përfshirë llogari të arkëtueshme, mjete monetare, huamarrje dhe huadhënie, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat jo me vlerë të drejtë kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Grupi bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve të parasë së aktivitetit financiar ose kur kompania transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontroll ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Grupi angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Grupit skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë arkën, depozitat në para me bankat, investime të tjera tejet likuide me maturim fillestar prej tre ose më pak muajsh.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar.

Huadhënie dhe huamarrje

Pas njohjes fillestare, huadhëniet dhe huamarrjet paraqiten me kosto të amortizuar dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në interesin efektiv të çdo difference midis kostos dhe vlerës së riblerjes përgjatë periudhës së huamarrjes.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

Instrumentat financiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përveç rastit kur Grupi ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

(h) Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

(i) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i shtyrë

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin për periudhën dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, në këtë rast tatimi njihet në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme. Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke marrë në konsideratë diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumat e përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin e miratuar në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në masën që është e mundshme që të ekzistojnë përfitime të ardhshme tatimore të vlefshme që diferencat e përkohshme mund të përdoren kundrejt tyre. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundshme që përfitimi tatimor në lidhje me to të realizohet.

(k) Përfitimet e punonjësve

- *Fondet e sigurimeve shoqërore, pensionale dhe të shëndetit*

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi Grupi është i detyruar të kryejë kontribute fikse për llogari të punonjësve në një fond të administruar nga qeveria. Të gjitha këto pagesa/detyrime njihen si shpenzim në periudhën të cilës i përkasin.

- *Përfitimet në përfundim të marrëdhënieve të punës*

Sipas kontratës kolektive të punës, në rast të përfundimit të kontratës së punësimit pasi punonjësi ka arritur moshën e kërkuar me ligj për daljen në pension, pavarësisht nga arsyeja e përfundimit, punonjësi ka të drejtën e një kompensimi prej 2 pagash mujore bruto.

Përfitimet në përfundimin e kontratës njihen si shpenzim kur Grupi është i përkushtuar pa ndonjë mundësi realiste tërheqje ndaj një plani formal dhe të detajuar që të përfundojë kontratën përpara datës normale të daljes në pension ose të sigurojë përfitimet e përfundimit si rezultat i një oferte për të përkrahur sigurimin vullnetar. Përfitimet në përfundimin e kontratës për sigurimet vullnetare njihen si një shpenzim nëse Grupi ka bërë një ofertë për sigurimin vullnetar dhe është e mundshme që oferta do pranohet dhe numri i pranimeve mund të matet në mënyrë të besueshme.

(l) Provigjionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Grupi ka një detyrim të tërthortë ligjor i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkohej flukse dalëse parash për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit.

(m) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteve të Grupit që rezultojnë në rritje të kapitalit gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit në tij të kontributeve të aksionerëve në kapital. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteve të Grupit.

Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet. Kur shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, Grupi i njeh të ardhurat duke u bazuar në faturat e lëshuara për furnizimin me energji. Shuma e të ardhurave nuk konsiderohet si e matshme me besueshmëri derisa nuk janë zgjidhur të gjithë kushtëzimet në lidhje me shitjen. Grupi bazohet në rezultatet historike, duke mbajtur parasysh llojin e klientit, tipin e transaksionit dhe specifikimet e çdo marrëveshjeje, për të kryer vlerësimet e veta.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Njohja e të ardhurave (vazhdim)

- *Shitja e energjisë*

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve bazuar në sasinë aktuale të energjisë elektrike të shitur për (i) FPP (CEZ Shpërndarje sh.a.); (ii) eksport jashtë vëndit; (iii) energji për mbulimin e humbjeve të OSSh sh.a.

(n) Qiratë

Qiratë në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiramarrësi klasifikohen si të qira operative. Pagesat e qirave të zakonshme (duke përjashtuar stimuluesit e vendosur nga qiramarrësi) njihen me metodën lineare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së qirasë. Shpenzimet për keestet minimale të qirase llogariten dhe evidentohen në përpjestim me kohën e maturimit të qirase, përgjate afatit të qirase, pavarësisht nga koha dhe shumat e paguar në fakt.

(o) Shpërndarja e dividendit

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare të Grupit si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

(p) Grantet qeveritare

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe Grupi do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të Grupit, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

(q) Standarte dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara .

Më 31 Dhjetor 2010 disa Standarde, amendime të Standardeve dhe Interpretime që janë publikuar nuk kanë hyrë ende në fuqi dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon t'i adoptojë këto ndryshime në përputhje me datën e hyrjes së tyre në fuqi. Këto publikime janë si vijon:

- **KIRFN 17, “Shpërndarja e aktiveve jo-mjete monetare të pronarët”** (në fuqi më ose pas 1 Korrik 2009). Interpretimi është pjesë e projektit vjetor të përmirësimeve nga SNK publikuar në Prill 2009. Ky interpretim ofron udhëzim në lidhje me shpjegimin e rregullimeve sipas të cilave një kompani shpërndan aktive jo monetare të aksionarët si shpërndarje rezervash apo dividendësh. SNRF 5 është amenduar gjithashtu duke kërkuar që aktivet të klasifikohen si të mbajtura për t'u shpërndarë vetëm kur ato janë të disponueshme për shpërndarje në gjendjen e tyre aktuale dhe shpërndarja ka shumë të ngjarë të ndodhë. Nuk pritet të ketë efekt material në pasqyrat financiare të shoqërisë. Ky interpretim nuk është i aplikueshëm për shoqërinë pasi ajo nuk ka bërë ndonjë shpërndarje aktivesh jo-monetare.
- **SNK 27 (i rishikuar) “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale”** (në fuqi që prej 1 Korrik 2009). Standardi i rishikuar kërkon që efektet e të gjitha transaksioneve me interesat jo-kontrollues të regjistrohen në kapitalin e vet nëqoftese nuk ka asnjë ndryshim në kontrollin dhe këto transaksione nuk do të rezultojnë më në “emër të mirë” apo fitime dhe humbje. Standardi specifikon gjithashtu trajtimin kur humbet kontrolli. Cdo interes i mbetur në shoqërinë rimatet me vlerën e drejtë dhe fitim-humbjet e mundshme njihen në pasqyrën e të ardhurave.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(q) Standarde dhe interpretime të reja ende të pa adoptuara (vazhdim)

- **SNRF 3 (i rishikuar) “Kombinimet e Bizneseve”** (në fuqi që prej 1 Korrik 2009). Standardi i rishikuar vazhdon të zbatojë metodën e blerjes ndaj kombinimit të bizneseve, me disa ndryshime të rëndësishme. Për shembull, të gjitha pagesat për blerjen e një biznesi duhen regjistruar me vlerën e drejtë në datën e blerjes, dhe pagesat e mundshme të klasifikuara si borxh ri-maten më pas përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse. Ekziston mundësia e zgjedhjes mbi bazën përvetësim pas përvetësimi, për të ri-matur interesin jo-kontrollues në biznesin e blerë me vlerën e drejtë ose pjesën proporcionale të interesit jo-kontrollues ndaj aktiveve neto të biznesit të blerë. Të gjitha kostot e lidhura me blerjen duhet të regjistrohen si shpenzime.
- **SNRF 2 (amendimet), “Transaksionet e shoqërisë me mjete monetare dhe aksione”**. Përveç përfshirjes së KIRFN 8, “Qëllimi i SNRF 2” dhe KIRFN 11, “SNRF 2 - Transaksionet me aksione të shoqërisë dhe aksionet e thesarit”, amendimet shtrihen në udhëzimet e KIRFN 11 për të adresuar klasifikimin e rregullimeve të grupit që nuk ishin mbuluar nga ai interpretim. Udhëzimi i ri nuk pritet të ketë efekt material mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- **IAS 39 “Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja – Instrumenta mbrojtës të pranuar”**. Amendimi sqaron se një njësi lejohet të emërtojë një pjesë të ndryshimeve të vlerës së drejtë ose luhatjeve të flukseve monetare të një instrumenti financiar si zëra të mbrojtur. Ky mbulon gjithashtu edhe përcaktimin e inflacionit si risk apo pjesë të mbrojtur në situata të caktuara.. Nuk pritet të ketë impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- **SNRF 9 “Instrumentat Financiarë”**. Në Nëntor 2009 BSNK filloi fazën e parë të SNRF 9 Instrumentat Financiarë. Ky standard përfundimisht do të zëvendësojë SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja. SNRF 9 hyn në fuqi për vitet financiare që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2013. Njesitë mund t’i adoptojnë fazën e parë për periudha raportimi që mbarojnë më ose pas 31 Dhjetorit 2009. Faza e parë e SNRF 9 prezanton kërkesat e reja mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Në vecanti, për matjen e mëpasshme, gjithë aktivet financiare duhet të klasifikohen me koston e amortizimit ose vlerën e drejtë përmes fitim-humbjeve me opsionin e parevokueshëm që instrumentat e kapitalit që nuk mbahen për tregtim të maten me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Shoqëria, duke marrë parasysh datën fillestare të zbatimit, po vlerëson ndikimin e adoptimit të standardit të ri.
- **SNK 32 “Prezantimi i Instrumentave Financiarë” dhe IAS 1, “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Instrumentat Financiare të kthyeshëm dhe Detyrimet që rrjedhin nga likuidimi (Rishikuar)**, u publikuan në Shkurt 2008 dhe hynë në fuqi për periudhat vjetore që fillonin më ose pas 1 Janarit 2009 me zbatim retrospektiv. Amendimet kërkojnë që instrumentat financiarë të kthyeshëm që paraqesin një interes të mbetur në një shoqëri të klasifikohen si kapital, nëqoftesë disa kritere të caktuara përmbushen. Amendimi i SKN 1 kërkon shpjegimin e informacioneve të caktuara që lidhen në instrumentat e kthyeshme të klasifikuar si kapital. Këto amendime nuk kanë pasur ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të shoqërisë.
- **SNRF 1, Limitet e përjashtimeve nga krahasimet, SNRF 7 Dhënia e informacionit për adoptimet për herë të parë (amenduar)**. Amendimet janë efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrikut 2010. Shoqëria nuk pret që këto amendime të kenë ndonjë impakt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare.
 - SNRF 1, Limitet e përjashtimeve nga krahasimet, SNRF 7 Dhenia e informacionit për adoptimet për herë të parë (amenduar). Amendimet janë efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Korrikut 2010. Shoqëria nuk pret që këto amendime të kenë ndonjë impakt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare.
 - KIRFN 14 - Parapagimet e kërkesave minimale për fonde (Amenduar). Amendimi është efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2011. Qëllimi i amendimit ishte të

lejonte njesite te njohin si aktive disa parapagime vullnetare per kerkesat minimale te financimit. Lejohet aplikimi me i hershem dhe duhet zbatuar ne menyre retrospektive. Shoqeria nuk pret qe amendimi te kete efekt mbi pasqyrat financiare apo performance.

- KIRFN 19 Shuarja e Detyrimeve Financiare me Instrumenta Kapitali (ne fuqi per per periudhat vjetore qe fillojne me ose pas 1 Korrikut 2010) - Interpretimi qarteson se instrumentat e kapitalit qe i emetohen nje kreditori per te fshire nje pjese ose te gjithë detyrimet financiare nepermjet nje “kontrate shkembimi borxh-kapital” jane shuma te paguara ne perputhje me SNK 39.41. Matja fillestare e instrumentave te kapitalit te emetuar per te fshire nje detyrim financiar eshte me vleren e drejte te atyre instrumentave te kapitalit, pervec ne rastet kur ajo vlere e drejte nuk mund te matet me besueshmeri, rast ne te cilin instrumenti i kapitalit duhet te matet per te reflektuar vleren e drejte te detyrimit financiar te fshire. Diferenca midis vleres se mbetur te detyrimit financiar (ose nje pjese te detyrimit financiar te fshire) dhe shumes fillestare te matjes se instrumentave te kapitalit te emetuar duhet te njihet ne fitim-humbje. Shoqeria nuk pret qe amendimi te kete efekt mbi pasqyrat financiare apo performance.
- SNK 24 Dhenia e informacioneve shpjeguese per palet e lidhura (I rishikuar). Rishikimi eshte efektiv per periudhat qe fillojne ne ose me pas 1 Janar 2011. Rishikimet lidhen me gjykimet qe kerkohen ne vleresimin nese qeveria dhe njesite qe sipas njesise raportuese jane nen kontrollin e qeverive te konsiderohen nje klient i vetem. Ne percaktimin e kesaj, njesia duhet te vleresoje integrimin ekonomik te ketyre njesive. Shoqeria nuk pret qe amendimi te kete efekt mbi pasqyrat financiare apo performance.
- SNK 32 Klasifikimi i te drejtave per emetim (Amenduar). Amendimi eshte efektiv per periudhat qe fillojne ne ose me pas 1 Shkurt 2010. Keto amendime lidhen me te drejtat e emetimit te ofruara per nje shume fikse te monedhave te huaja te cilat ishin trajtuar si detyrime derivative ne standartin ekzistues. Amendimi thote qe ne rast se permbushen kriteret te vecanta, keto mund te klasifikohen si kapital pavaresisht nga monedha ne te cilen eshte percaktuar cmimi i ushtrimit. Amendimi duhet te aplikohet ne retrospektive. Shoqeria nuk pret qe amendimi te kete efekt mbi pasqyrat financiare apo performance.
- Ne Prill 2009, BSNK leshoi permbledhjen e dyte te amendimeve te standarteve, kryesisht me synimin per te eliminuar mosperputhjet dhe qartesuar fjalet. Datat efektive per implementim jane te ndryshme duke filluar nga periudha financiare qe fillon me 1 Korrik 2009. Keto permiresime lidhen me SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9 dhe KIRFN 16. Keto permiresime nuk pritet te kene efekt mbi pozicionin financiar apo rezultatin e Shoqerise.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda Grupit është realizuar për rreziqet financiare (kredia, tregu, monedha, likuiditeti dhe norma e interesit), rrezikun operacional (siç është rreziku mjedisor) dhe rrezikun ligjor. Objektivat kryesore të funksionit të menaxhimit të rrezikut janë përcaktimi i kufijve të rrezikut dhe sigurimi që ekspozimi ndaj rreziqeve të qëndrojë brenda këtyre kufijve. Funksionet e menaxhimit të rrezikut operacional dhe atij ligjor kanë për qëllim të sigurojnë funksionimin e duhur të politikave dhe procedurave të brendshme për të minimizuar këto rreziqe.

Zhvillimet aktuale

Grupi vepron në kushtet e një krize ekonomike dhe financiare globale dhe që zhvillohet në mënyrë dinamike. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në pasoja negative mbi pozicionin financiar dhe ekonomik të Grupit. Drejtimi i Grupit kryen monitorim të rregullt mbi të gjitha pozicionet e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimin e tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këto, menaxhimi analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve si dhe kërkon të implementojë masa të përshtatshme në lidhje me kredinë, tregun (kryesisht normat e interesit), dhe riskun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, duke mbajtur një pozicion kapital dhe likuid të qëndrueshëm Grupi i përgjigjet sfidave të tregut.

4.1 Rreziku i kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë i cili është rreziku që një palë në një instrument financiar të shkaktojë një humbje financiare ndaj palës tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Ekspozimi kryesor i Grupit ndaj rrezikut të kredisë vjen si pasojë e llogarive të arkëtueshme e të tjera Kreditë e marra nga Grupi financojnë projekte që do të rezultojnë në aktive që do të materializohen ose janë materializuar në KESH, OST, ose CEZ Shpërndarje dhe në një rast të tillë marrveshja kryesore e kredisë në të cilën Grupi dhe njësi financuese kanë hyrë është ndarë me tej në nën-marrveshje kredie midis Grupit dhe OST ose CEZ Shpërndarje.

Ekspozimi maksimal i Grupit ndaj rrezikut të kredisë sipas kategorisë së instrumentit financiar dhe sipas kategorisë së aktiveve para kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të kredisë është si vijon:

<i>Në mijë Lek</i>	2010	2009
<i>Hua dhe llogari të arkëtueshme</i>		
Mjete monetare në bankë	2,155,654	816,420
Llogari të arkëtueshme		
- Klientë familjarë	17,574,885	17,578,057
- Shoqëri private	8,412,808	4,119,064
- Njësi të kontrolluara nga shteti	425	425
Hua dhe llogari të arkëtueshme	27,127,992	24,374,665
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	40,447	42,339
Llogari të arkëtueshme në lidhje me çështjen “Jacobsen”	168,173	168,173
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike	865,732	882,469
Të tjera	2,955,113	1,421,889
Ekspozimi total ndaj rrezikut të kredisë	59,301,229	49,403,502

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

4.1.1 Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të kredisë sepse është e mundur që klientët ose huamarrësit të dështojnë të shlyejnë detyrimet e tyre financiare. Grupi strukturon nivelet e rrezikut të ndërmarrë të kredisë duke vendosur kufij në shumën e pranuar të rrezikut nga palët e tjera apo grupe palësh të tjera. Kufijtë e niveleve të rrezikut të kredisë aprovohen rregullisht nga drejtuesit. Këto rreziqe monitorohen periodikisht dhe janë objekt i një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë.

Për më tepër, rreziku i kredisë që lidhet me marrëveshjet e kredisë të Grupit menaxhohet dhe monitorohet mbi bazën e nën-marrëveshjeve të mëtejshme të kredisë mes Grupit dhe përfituesve të projekteve të huaja të financimit. Këto marrëveshje përfshijnë kushte dhe angazhime të cilat ndihmojnë Grupin në monitorimin dhe minimizimin e rrezikut të kredisë. Këto angazhime analizohen dhe monitorohen rregullisht siç kërkohet nga marrëveshja origjinale e kredisë.

4.1.2 Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Grupi është i ekspozuar ndaj përqendrimit të rrezikut të kredisë. Drejtuesit monitorojnë përqendrimin e rrezikut të kredisë, por ndeshin vështirësi në zbatimin e praktikës më të mirë të politikave të menaxhimit mbi ekspozimin e Grupit ndaj këtij rreziku përmes diversifikimit të portofolit të kredisë. Kjo për shkak se grupi është i detyruar të furnizojë me energji si konsumatorët finalë me tarifë ashtu edhe Furnizuesin me Pakicë të Sektorit Publik (FPSP) nëpërmjet Furnizuesit me Shumicë të Sektorit Publik (FSHSP) sipas modelit të tregut. Në këto rrethana, masat për diversifikim janë të vështira për t'u zbatuar. Në rastin e shitjes së energjisë nga FSHSP tek FPSP përqendrimi i rrezikut është tepër i lartë duke qenë se ka vetëm një klient. Grupi po shqyrton përdorimin e instrumenteve financiarë për zvogëlimin e këtij rreziku.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i humbjes si rezultat i ndryshimeve në çmimet e tregut (çmimet e mallrave të energjisë), kurset e këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e kapitalit. Niveli i rrezikut të tregut ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive për ndryshime të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Grupit.

4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen nga fakti se të ardhurat e Grupit dhe shumica e huave dhe llogarive të arkëtueshme janë të shprehura në Lekë, ndërkohë që një pjesë e madhe e kredive të grupit janë të shprehura në monedha të huaja (kryesisht Euro, Yen Japonez dhe Dollarë Amerikan). Rreziku është që vlera e monedhës së flukseve të parasë nga shlyerja e kredive dhe interesit përkatës, si dhe nga pagesa e faturave për energjinë e importuar, do të ndryshojë si rezultat i lëvizjeve në kurset e këmbimit të cilat mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në fitimin e Grupit.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

4.2.1 Rreziku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e grupit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të monedhave të huaja në datën e bilancit:

Në mijë Lek	Më 31 Dhjetor 2010			Më 31 Dhjetor 2009		
	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit	Aktive financiare monetare	Detyrime financiare monetare	Pozicioni neto i bilancit
LEK	27,446,205	(14,021,435)	13,424,770	25,478,168	(26,111,357)	(633,189)
EUR	20,925,117	(36,574,557)	(15,649,440)	12,495,732	(32,372,250)	(19,876,518)
USD	2,392,143	(6,931,728)	(4,539,585)	5,735,481	(7,325,432)	(1,589,400)
YEN	3,719,583	(3,907,081)	(187,498)	2,167,420	(1,934,731)	232,689
CHF	1,450,034	(2,412,496)	(962,462)	745,351	(3,134,751)	(2,389,400)
Të tjera	3,642,335	(2,194,660)	1,447,675	3,075,726	(1,003,234)	2,072,492
Totali	59,575,417	(66,041,957)	(6,466,540)	49,697,878	(71,881,755)	(22,183,877)

Analiza e mësipërme përfshin vetëm aktivet dhe detyrimet monetare. Investimet në kapital dhe aktive jo-monetare nuk konsiderohet të sjellin ndonjë rrezik material të kursit të këmbimit.

Me qëllimin për të optimizuar koston e financimit, në disa raste, Grupi ka marrë kredi në monedhë të huaj, kryesisht në Dollarë Amerikan, Euro dhe Yen Japonez.

4.2.2 Rreziku i normës së interesit

Grupi merr hua në rrjedhën normale të biznesit për financimin e veprimtarisë së tij. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit sepse vlera e drejtë e kredive me normë fikse si dhe flukset e parasë prej kredive me normë të ndryshueshme do të luhet sipas luhatjeve në normat e interesit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Grupit ndaj rreziqeve të normës së interesit. Tabela paraqet shumat e totale të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit të kategorizuara sipas datës më të hershme midis datës së riçimit të interesit kontraktual dhe datës së maturimit.

Në mijë Lekë	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 1 deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
31 Dhjetor 2010				
Totali i aktiveve financiare monetare	35,052,096	9,328,181	15,195,140	59,575,417
Totali i detyrimeve financiare monetare	(26,199,094)	(17,016,272)	(22,826,590)	(66,041,956)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2010	8,853,002	(7,688,091)	(7,631,450)	(6,466,540)
31 Dhjetor 2009				
Totali i aktiveve financiare monetare	37,436,153	2,467,541	9,794,184	49,697,878
Totali i detyrimeve financiare monetare	(39,453,156)	(14,567,467)	(17,861,132)	(71,881,755)
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit më 31 Dhjetor 2009	(2,017,003)	(12,099,926)	(8,066,948)	(22,183,877)

4.2.3 3 Rreziqe të tjera të çmimeve

4.2.3.1 Çmimet e instrumenteve të kapitalit

Grupi nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të instrumenteve të kapitalit pasi nuk mban aktive financiare që të përfshijnë instrumente të kapitalit në datën e bilancit. Nuk është politikë e Grupit të blejë instrumente të tillë dhe të ekspozohet ndaj rrezikut të çmimit lidhur me lëvizjet në indekset e tregut të kapitalit.

4.2.3.2 Çmimet e energjisë

Duke filluar nga data 1 Janar 2010, ERE ka aprovuar çmime të reja konsumi për energjinë për periudhën nga data 1 Janar 2010 deri 31 Dhjetor 2010 dhe mbas kesaj date nuk është aprovuar asnjë çmim tjetër për shitjen e energjisë deri në fund të vitit ushtrimor. Brenda kontekstit të modelit të ri të tregut, FPSH-ja do të furnizojë CEZ Shperndarje sh.a dhe OST sh.a. me çmime energjie të vendosura nga ERE. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike tek CEZ Shperndarje sh.a., i aprovuar nga ERE gjatë vitit 2010 ishte Lek 2.03 për kWh dhe te OST sh.a. Lek 0.4 për kWh. Çdo sasi tjetër energjie, e cila nuk përfshihet në detyrimin sipas modelit të tregut për furnizimin e CEZ Shperndarje sh.a. dhe OST sh.a. është subjekt i çmimeve të tregut sipas marrëveshjeve respektive të shitjes.

Për të menaxhuar rrezikun, Shoqëria optimizon aktivitetet e saj dhe portofolin e kontratave nëpërmjet një metode bazuar në analiza të hollësishme të pozicionit të ofertës dhe kërkesës dhe në vlerësime të vazhdueshme të tregjeve lokale në të cilat ajo operon. Politika nuk nënkupton mbrojtjen e një pjese të ekspozimit.

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të çmimeve të energjisë në prokurimin e energjisë dhe aktivitetet e ngjashme sepse kosto e prokurimit të energjisë për të përmbushur nevojat e konsumatorëve të saj, ndryshon së bashku me çmimet e shitjes me shumicë. Rreziku është kryesisht në faktin që çmimet e tregut për energji do të ndryshojnë midis kohës në të cilën çmimet e shitjes janë fikse apo tarifat janë të përcaktuara dhe kohës në të cilën përcaktohet kosto e prokurimit përkatës, duke zvogëluar në këtë mënyrë marzhet e pritshme apo duke rezultuar në shitje pa fitim.

Paparashikueshmëria e çmimeve të energjisë, veçanërisht me pasigurinë e regjimeve të ardhshme të tregtisë, vështirëson llogaritjen e parashikimeve të besueshme për të mbështetur vendimet për investime duke çuar në kthyeshmëri potenciale më të vogël se ajo e pritshme.

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që njësi të ndeshë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të saj financiare. Grupi është i ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë kryesisht për të paguar shpenzimet operative të ndeshura në aktivitetin e saj të zakonshëm dhe për të shlyer kreditë. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga drejtuesit e Grupit. Drejtuesit monitorojnë çdo ditë, javë dhe muaj parashikimet periodike të flukseve të parasë së Grupit.

Procesi i adoptuar nga drejtuesit për menaxhimin e likuiditetit përfshin edhe vendosjen e kufizimeve ndaj degëve për shpenzimet në lidhje me aktivitetet e përditshme si shërbimet, furnizimet si dhe për investimet, shtyrjen e pagesave ndaj disa kreditorëve ose riskedulimin e marrëveshjeve midis palëve dhe parashikimin e pagesave të kredive duke siguruar që këto të jenë të mbuluara, përdorimin e Fondit të Balancimit, etj.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**4.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela që vijon tregon detyrimet sipas maturimit të tyre të kontraktuar. Shumat e paraqitura në tabelën e maturimit janë flukse kontraktuale të paskontuara të parasë, duke përfshirë pagesat e kredive.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, shuma që paraqitet është përcaktuar duke iu referuar kushteve që kanë ekzistuar në datën e raportimit. Pagesat në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin ditor të këmbimit në datën e bilancit.

Analiza e vjetërsisë së detyrimeve financiare më 31 Dhjetor 2010 është si vijon:

Detyrimet më 31 Dhjetor 2010	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	13,064,372			13,064,372
Kredi dhe hua	13,134,722	17,016,272	21,909,306	52,060,300
Detyrime të tjera afat-gjata			917,284	
Totali i pagesave të ardhshme	26,199,094	17,016,272	22,826,590	66,041,957

Detyrimet më 31 Dhjetor 2009	Nga 1 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Llogari të pagueshme e të tjera	13,038,256	-	-	13,038,256
Kredi dhe hua	23,060,846	13,030,233		22,752,420
Detyrime të tjera afat-gjata				
Totali i pagesave të ardhshme	36,099,102	13,030,233	22,752,420	71,881,755

4.4 Vlerat e drejta

Vlera e drejtë është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një instrument financiar në një transaksion të zakonshëm mes palëve të mirëinformuara, e që nuk përbën një shitje të detyruar ose likuidim, dhe përfaqësohet më së miri nga një çmim i vlerësuar në një treg aktiv.

4.4.1 Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e huave dhe llogarive të arkëtueshme supozohet se është e përafërt me vlerën e tyre kontabël duke qenë se ato janë instrumente afat-shkurtër që nuk mbartin interes.

4.4.2 Detyrime të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e detyrimeve të ripagueshme në të parë supozohet se është shumë e përafërt me vlerën kontabël. Shumat e ardhshme të pagueshme skontohen me norma që variojnë nga 2.04% në vit në 4.61% në vit (2009: nga 2.16% në vit në 5.72% në vit), në varësi të maturimit dhe monedhës në të cilën është shprehur detyrimi. Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme e të tjera janë të përafërta me vlerat e tyre të drejta.

4.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Grupit në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e Grupit për vijimësi të biznesit me qëllim të mundësimin të kthyeshmërisë për aksionarët dhe të përfitimeve për grupe të tjera të interesit dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të reduktuar koston e kapitalit. Grupi mund të përcaktojë shumën e dividendëve të paguar, kthyeshmërinë e kapitalit ndaj aksionarëve, të emetojë aksione të reja apo të shesë aktive për të reduktuar huamarrjen me qëllim që të ruajë apo për të ndryshuar strukturën e kapitalit.

Ashtu si ndodh në industri të tjera, Grupi monitoron kapitalin në bazë të raportit të borxhit. Ky raport llogaritet si total i detyrimeve përmbi totalin e kapitalit nën administrim. Grupi vlerëson se totali i kapitalit nën administrim është i barabartë me kapitalin siç tregohet në bilancin kontabël të konsoliduar. Grupi nuk ka kërkesa nga legjislacioni vendas në lidhje me kapitalin.

5. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë të bazuara në eksperiencën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, që përfshijnë ngjarje që priten të ndodhin në të ardhmen. Këto vlerësime dhe gjykime mendohet të jenë të arsyeshme në rrethanat e dhëna.

Grupi bën vlerësime dhe supozime që lidhen me të ardhmen. Këto vlerësime kontabël, teorikisht, rrallë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një korrigjim material të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar paraqiten më poshtë.

(a) Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë

Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë të cilët nuk janë tregtuar në një treg aktiv (p.sh. huatë ndaj punonjësve dhe kreditë) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Grupi përdor gjykimin e tij për të zgjedhur një shumëllojshmëri metodash dhe për të bërë supozime të cilat bazohen kryesisht në kushtet ekzistuese të tregut në çdo datë bilanci. Për aktivet dhe detyrimet financiare që nuk tregtohen në tregje aktive, Grupi përdor analizën e skontimit e flukseve të parasë.

(b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Drejtuesit e Grupit përcaktojnë jetëgjatësinë e pritshme dhe normat e zhvlerësimit, lidhur me aktivet e qëndrueshme të zotëruara. Ky vlerësim bazohet në ciklin e projektuar të jetës së aktivit. Ai mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e tregut. Këto ndryshime në jetën e aktiveve, mund të çojnë në rregullime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël neto.

(c) Rënia në vlerë e aktiveve financiare (huave dhe llogarive të arkëtueshme)

Grupi bazohet në udhëzimet e SNK 39 për të përcaktuar se kur një aktiv financiar është i rënë në vlerë. Ky përcaktim kërkon një gjykim të rëndësishëm. Për të gjykuar mbi të, Grupi vlerëson, midis faktorëve të tjerë, kohëzgjatjen dhe nivelin në të cilin vlera e drejtë e një investimi është më e vogël se kosto e tij dhe flukset operative dhe financiare të parasë.

Shuma e rënies në vlerë dhe llogaritë përkatëse të arkëtueshme paraqiten në shënimin 7. Rishqyrtimi i rënies në vlerë të llogarive të arkëtueshme në vitet e ardhshme mund të çojë në korrigjime të rëndësishme të vlerës së tyre kontabël.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

6. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Orendi, instalime dhe pajisje	Ndërtime në proces dhe paradhënie ndaj furnitorëve	Totali
31 Dhjetor 2008	484,564	20,839,926	11,623,042	179,538	144,886	9,573,981	42,845,937
Blerje te reja	-	27,392	186,348	84	8,693	8,326,796	8,549,312
Shtesa	-	-	-	-	-	-	-
Shtesa nga magazina	-	-	2,639	9,037	62	-	11,738
Sist grupi	-	-	-	-	-	-	-
Mardhenie te brendeshme	-	-	86,842	7,653	1,178	-	95,672
Sist Tec Vlore	-	-	7,456	-	-	-	7,456
Nxjerrje jashtepdorimit	-	-	(14,245)	(1,714)	(446)	-	(16,404)
Tec Korce	(528)	(198,849)	(129)	-	(483)	-	(199,989)
Kalim ne magazine	-	-	(16,735)	(4,757)	(46)	-	(21,539)
Mardhenje te brendeshme	-	-	(893)	(11,966)	(14,876)	(66,187)	(93,922)
Riklasifikim i procesit	-	25,175	742,255	-	422	(767,852)	-
Tjeter	-	-	-	-	-	(2,243,395)	(2,243,395)
31 Dhjetor 2009 KESH Konsoliduar	484,036	20,693,644	12,616,579	177,874	139,389	14,823,344	48,934,865
Shtesa blerje te reja	-	-	207,787	350	29,917	1,806,942	2,044,996
Shtesa nga rivleresimi	882,614	-	-	-	-	-	882,614
Shtesa te tjera	-	55,891	353,970	3,598	13,563	193,284	620,306
Pakesime te tjera transferim cez & ost	(22,058)	(8,356)	(586,589)	-	(6)	(2,759,816)	(3,376,825)
Pakesime te tjera (ulje kapitali)	(83,895)	(250,815)	-	-	-	-	(334,710)
Nxjerrje jashte perdorimit	-	(54,746)	(177,016)	(304)	(77)	-	(232,143)
Pakesime te tjera	(5)	(7,918)	(346,578)	(1,039)	(47,333)	(92,405)	(495,278)
31 Dhjetor 2010	1,260,692	20,427,701	12,068,152	180,480	135,453	13,971,349	48,043,826
Zhvlërësimi i akumuluar							
31 Dhjetor 2008	(601)	(2,362,119)	(3,187,146)	(83,815)	(67,253)		(5,700,934)
Shtesa	(51)	(338,300)	(392,169)	(23,454)	(12,192)		(766,165)
Sist grupi	-	-	-	-	-		-
Mardhenie te brendeshme	-	-	-	(893)	-		(893)
Sist Tec Vlore	-	-	(7,341)	-	(115)		(7,456)
Nxjerrje jashtepdorimit	-	-	14,145	1,404	388		15,937
Tec Korce	69	13,919	4	-	431		14,423
Kalim ne magazine	-	-	570	220	22		813
Mardhenje te brendeshme	-	-	-	2,620	5,511		8,131
Tjeter	-	-	-	-	-		-
31 Dhjetor 2009 KESH Konsoliduar	(583)	(2,686,499)	(3,571,936)	(103,918)	(73,209)	-	(6,436,145)
Amortizimi i vitit 2010	(51)	(327,211)	(425,928)	(15,700)	(12,753)	-	(781,642)
Shtesa te tjera	-	(4)	-	(625)	(2,003)	-	(2,633)
Pakesime te tjera transferim cez & ost	-	-	58,011	-	3	-	58,014
Pakesime te tjera (ulje kapitali)	335	64,821	-	-	-	-	65,157
Nxjerrje jashte perdorimit	-	15,043	63,095	207	41	-	78,386
Pakesime te tjera	4	7,917	4,488	1,040	11,029	-	24,478
31 Dhjetor 2010	(294)	(2,925,933)	(3,872,270)	(118,996)	(76,892)	-	(6,994,385)
Vlera kontabël më:							
1 Janar 2009	483,963	18,477,807	8,435,896	95,723	77,633	9,573,981	37,145,003
31 Dhjetor 2009	483,453	18,007,145	9,044,643	73,955	66,180	14,823,344	42,498,720
31 Dhjetor 2010	1,260,398	17,501,768	8,195,882	61,484	58,561	13,971,349	41,049,441

Ne Aktive afatgjata materiale hyjne mjetet e punes si : Tokat, trojet, ndertesat, makinerite dhe pajisjet, mjetet e transportit, paisjet informatike, paisjet e zyrave, etj.

Aktive afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2010 përfshijnë aktive me një vlerë prej 41,049,441 mijë.Vlera e tyre, si shpenzim shume vjecar eshte shperndare midis ushtrimeve vjetore, ne perpjestim te drejte me konsumin e tyre ekonomik te ralizuar ne cdo vit perkates, perjashtim nga amortizimi eshte bere vetem tek toka.

Nuk ka ndonje aktiv te lene si kolateral deri me 31 Dhjetor 2010.

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

7. Llogari të arkëtueshme

	2010	2009
Llogari të arkëtueshme	49,080,972	44,790,402
Minus: provizioni për rënien në vlerë	(23,092,854)	(23,092,854)
Llogari të arkëtueshme – neto	25,988,118	21,697,548
Llogari të arkëtueshme nga punonjësit	40,447	42,339
Llogari të arkëtueshme nga çështja “Jacobsen”	168,173	168,173
Llogari të arkëtueshme nga Shërbimi i Kontrollit të Energjisë Elektrike (“SHKEE”)	865,732	882,469
Të tjera	2,955,113	1,421,889
	30,017,583	24,212,418

Llogaritë e arkëtueshme mund të ndahen më tej në:

Familjare	40,667,739	40,670,912
Shoqëri private	8,412,808	4,119,064
Njësi të kontrolluara nga shteti	425	425
	49,080,972	44,790,402

Grupi nuk ka njohur humbje shtesë për rënien në vlerë të llogarive të tij të arkëtueshme gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2010. Me ligjin nr.10418 dt.21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” do të trajtohen dhe llogaritë e arkëtueshme, pjesa më e madhe e të cilave trajtohet në nenin 29 “Falja e detyrimeve të papaguara të energjisë elektrike” të ligjit të sipërcituar.

Llogaritë e arkëtueshme të Grupit janë vendosur si kolateral për huatë e marra nga bankat. (Duhet shtuar ligji për faljen)

Instrumentat financiarë sipas kategorisë

Politikat kontabël për instrumentet financiarë janë zbatuar ndaj zërave të mëposhtëm:

	2010	2009
Hua dhe te arkëtueshme		
Aktive financiare	27,127,992	24,374,665
Llogari të arkëtueshme e të tjera	30,017,583	24,212,418
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	2,429,844	1,110,795
Totali	59,575,419	49,697,878
Detyrime financiare		
Llogari të pagueshme e të tjera	13,064,372	13,038,256
Kredi dhe hua	52,060,300	58,843,499
Detyrime të tjera	917,284	-
Totali	66,041,956	71,881,755

8. Inventarë

	2010	2009
Materiale të para	1,371,955	2,773,963
Lëndë djegëse	1,485,553	-
Produkt i gatshëm		212,086
	2,857,509	2,986,049

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

9. Aktive financiare

	2010	2009
Aktive afat-gjata		
Hua ndaj palëve të treta	24,484,888	22,016,691
Hua ndaj punonjësve	38,435	44,843
	24,523,324	22,061,534
Aktive afat-shkurtra		
Hua ndaj palëve të treta	2,600,145	2,310,492
Hua ndaj punonjësve	4,524	2,639
	2,604,668	2,313,131
	27,127,992	24,374,665

Aktivitetet financiare më 31 Dhjetor 2009 dhe 31 Dhjetor 2010 përfshijnë kredi të dhëna OST sh.a. dhe CEZ Shperndarje sh.a. sipas marreveshjeve respektive dhe kredi të dhëna punonjësve të Grupit.

10. Mjete monetare në arkë e bankë

	2010	2009
Arka	175	136
Banka	2,155,654	816,420
Para në udhëtim	154	154
Mjete monetare të ngurtësuar	273,862	294,085
	2,429,844	1,110,795

Mjetet e ngurtësuar monetare përfaqësojnë depozita si garanci kundrejt pagesave ndaj letrave të kredisë të krijuara në favor të furnitorëve të huaj. Për qëllime të pasqyrës së flukseve të parasë, mjetet monetare në arkë e bankë përfshijnë si vijon:

	2010	2009
Mjete monetare ne arke dhe banke	2,429,844	1,110,795
Mjete monetare të ngurtësuar	(273,862)	(294,085)
Overdraftet bankare	(9,574,838)	(13,978,035)
	(7,418,856)	(13,161,325)

Overdraft-et janë pjesë e kredive bankare afat-shkurtra në shumën 9,574,838 Lek (2009: 13,978,035 Lek) (Shënimi 13).

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

11. Kapitali aksioner dhe rezervat

	Totali kapitalit aksioner të regjistruar	Shtesa të kapitalit aksioner të paregjistruar	Pakësim i kapitalit aksioner të paregjistruar	Totali i kapitalit aksioner
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	20,735,161	8,085,331	(30,273,312)	(1,452,820)
Sistemim kapitali	(14,890,793)	(8,085,331)	22,976,124	-
Tjeter			3,309,853	3,309,853
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	5,844,368	-	(3,987,335)	1,857,033
Regjistrim ne QKR i uljes se Kapitalit	(3,983,336)		3,983,336	-
Ulje Kapitali per asetet e Tec-eve	(309,254)			(309,254)
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,551,778	-	(4,000)	1,547,778

Numri total i aksioneve të autorizuara të cilat janë regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit është 1,551.77 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë për aksion. Të gjitha aksionet e emetuara janë plotësisht të paguara.

Ne zbatim te urdherit te ministrit nr.818 dt.24.11.2010 “Per zvogelimin e kapitalit te KESH sha ” prej 3,983,336 mije leke eshte kryer veprimi prane QKR-s.

Ne zbatim te urdherit te ministrit nr.890 dt.20.12.2010 “Per zvogelimin e kapitalit te KESH sha ” prej 309,254 mije leke eshte kryer veprimi prane QKR-s.

12. Llogari të pagueshme e të tjera

	2010	2009
Llogari të pagueshme	2,496,883	2,943,641
Llogari të pagueshme ndaj personelit	72,306	60,424
TVSH e pagueshme		519,306
Sigurimet shoqërore dhe tatime të tjera	56,820	65,358
Tatim Fitimi	1,125,080	
Llogari të pagueshme ndaj SHKEE	236,928	236,928
Dividendë të pagueshëm	128,331	-
Llogari të pagueshme dhe të tjera për tu sistemuar	2,020,092	
Të tjera	7,845,216	9,212,599
	13,981,656	13,038,256

13. Kredi dhe hua

	2010	2009
Afat-gjata		
Kredi dhe hua bankare	22,604,851	23,539,827
Hua nga qeveria	16,320,851	12,242,826
	38,925,578	35,782,653
Afat-shkurtra		
Kredi dhe hua bankare	11,998,445	14,813,737
Hua nga qeveria	1,136,277	8,247,109
	13,134,722	23,060,846
Totali i kredive dhe huave	52,060,300	58,843,499

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

13. Kredi dhe hua (Vazhdim)

Totali i huave përfshin huatë dhe kreditë nga bankat dhe qeveria. Huatë nga bankat janë siguruar me garanci nga Qeveria e Shqipërisë.

Ekspozimi i kredive dhe huave të Grupit ndaj ndryshimeve të normës së interesit dhe datave të kontraktuara të rënimimit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	4,61%	3,88%	3,62%	2,04%	-
Hua nga qeveria	4.61%	3,88%	3,62%	2,04%	-

	31 Dhjetor 2009				
	EUR	USD	CHF	YEN	LEK
Kredi dhe hua bankare	4,51%	4,10%	2.84%	2,16%	-
Hua nga qeveria	4.51%	4,10%	2.84%	2,16%	-

Vlerat e drejta për kreditë dhe huatë afat-gjata janë si vijon:

	Vlera kontabël	
	2010	2009
Kredi dhe hua	22,604,851	23,539,827
Hua nga qeveria	16,320,727	12,242,826
TOTALI	38,925,578	35,782,653

Vlerat e drejta janë bazuar në flukset e skontuara të parasë duke përdorur një normë të bazuar në normën e kredive dhe huave prej 4.61% p.a. (2009: 4.51% p.a.) për kreditë dhe huatë e shprehura në Euro, 2.04% p.a. (2009: 2.84% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në CHF, 2.04% p.a. (2009: 2.16% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në YEN , 3.88% p.a. (2009: 4.10% p.a.) për kreditë dhe huat e shprehura në USD. Vlerat kontabël të kredive dhe huave afat-shkurtra janë të përafërta me vlerat e drejta.

Vlerat kontabël të kredive dhe huave të Grupit janë shprehur në monedhat e mëposhtme:

	2010	2009
Euro	30,262,674	30.141.390
US dollar	6,892,396	8,081,191
CHF	2,281,826	2,358,306
YEN	3,891,790	3,993,841
KWN	2,194,660	2,608,544
LEK	6,536,954	11,660,227
	52,060,300	58,843,499

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

14. Tatimi i shtyrë mbi fitimin

Aktivitet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë mbi fitimin kompensohen midis tyre kur ka një të drejtë të ligjshme të zbatueshme për të kompensuar aktivitet afat-shkurtër tatimore me detyrimet afat-shkurtër tatimore dhe kur tatimet e shtyra mbi fitimin lidhen me të njëjtin autoritet fiskal. Tatimi i shtyrë llogaritet bazuar në normën tatimore të miratuar prej 10% (2000: 10%).

	2010	2009
Aktive të shtyra tatimore	-	-
Detyrime të shtyra tatimore	858,510	885,167
Detyrime të shtyra tatimore (neto)	858,510	885,167

Lëvizja bruto në llogarinë e tatimit të shtyrë mbi fitimin është si vijon:

Fillimi i vitit	885,167	891,987
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave	(26,657)	(6,820)
Fundi i vitit	858,510	885,167

Lëvizja në aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra gjatë vitit, pa marrë në konsideratë kompensimin e gjendjeve me juridiksion fiskal të ndryshëm është si vijon:

Detyrime të shtyra tatimore	Kredi dhe hua	Sub-vencione	Ndihma	Diferenca të parealizuar këmbeimi	Maturuar	Totali
Më 31 Dhjetor 2008	891,987	-	-	-	-	891,987
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(6,820)	-	-	-	-	(6,820)
Më 31 Dhjetor 2009	885,167	-	-	-	-	885,167
Regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	(26,657)	-	-	-	-	(26,657)
Më 31 Dhjetor 2010	858,510					858,510

15. Grante

	2010	2009
Grante dhe subvencione	98,338	273,383
Shtesa gjate vitit	2,926	5,875
Amortizimi i granteve	(5,938)	(5,792)
Axhustimi i 2008		(175,127)
Te ardhura te shtyra		2,020,092
Total	95,326	2,118,430

Subvencionet qeveritare lidhen me sigurimin e shërbimeve dhe aktiveve dhe mund të jenë subvencione drejtpërdrejtë nga qeveria ose nga donatorë të qeverisë shqiptare për aktivitetet e Grupit.

16. Të ardhura

	2010	2009
Energji elektrike	25,706,450	10,725,518
Sherbime	14,426	15
Te tjera	1,662	841
	25,722,538	10,726,452

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

17. Të ardhura të tjera operative (të ardhura të tjera nga shfrytëzimi)

	2010	2009
Të ardhura nga gjobat mbi pagesat e vonuara	1,939	189,220
Të ardhura nga grantet dhe shërbime të tjera	23,402	55,158
Të tjera	287,806	232,091
	313,147	476,470

18. Shpenzime personeli

	2010	2009
Shpenzime për paga	752,781	670,062
Kontribut për sigurime shoqërore	147,658	148,026
Kosto stafi të tjera	349,457	293,832
	1,249,896	1,111,920

19. Shpenzime të tjera

	2010	2009
Shërbime të pajtuara	222,605	274,968
Mirëmbajtje	47,222	25,591
Telefon dhe postë	24,484	29,708
Shpenzime dietash për udhëtime biznesi	71,683	41,959
Komisione bankare	24,611	62,842
Tatime, taksa dhe të ngjashme	25,267	45,374
Gjoha dhe ndëshkime	518,810	40,705
Të tjera	2,171,307	147,623
	3,105,991	668,770

20. Shpenzime financiare neto

	2010	2009
Shpenzime interesi:		
– kredi dhe hua bankare	2,009,474	2,282,699
– rritje e skontimeve të periudhave të mëparshme		-
Shpenzime të tjera financiare		-
Fitime neto nga kursi i këmbimit në aktivitetet financiare	1,039,070	3,118,930
Të ardhura interesi nga kredite dhe depozitat bankare	(521,135)	(957,287)
Të ardhura financiare të tjera		(18)
Shpenzime financiare neto	2,527,409	4,444,324

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

21. Kreditim i tatimit mbi fitimin

	2010	2009
Tatim fitimi i llogaritur	1,795,544	76,620
Tatim fitimi i shtyre	(26,657)	(6,820)
	1,768,887	69,800

Tatimi i të ardhurës para fitimit të Grupit ndryshon nga shuma teorike që do të lindë duke përdorur normën tatimore mesatare të ponderuar që zbatohet ndaj fitimeve të shoqërive të konsoliduara si më poshtë:

	2010	2009
Fitim /(Humbja) para tatimit	17,098,824	3,422,676
Tatimi i perlllogaritur me 10%	1,709,882	342,268
Shpenzime te panjohura per qellime tatimore	51,955	13,820
Te ardhura te patatueshme	7,049	(3,870)
perdorimi i humbjeve tatimore		(282,418)
Perfitimi tatimor	1,768,887	69,800

22. Blerje energjie

Blerja e energjisë është si më poshtë:

	2010	2009
Energji e importuar	-	286,213
Energji e prodhuar në vend	1,118,307	586,538
	1,118,307	872,752

Gjate vitit 2010 Grupi nuk ka importuar energji si pasoje e rritjes se sasise se energjise se prodhuar nga burimet e veta. Rritja në shpenzimet për blerje energjie nga koncesionet është në saj të rritjes së sasisë së prodhuar të energjisë ne vend si pasoje e situates hidrike .

Sasia e energjisë e sipas burimit të furnizimit është si vijon:

	2010 (në MWH)	2009 (në MWH)
Prodhuar dhe furnizuar brenda Grupit	7,543.437	5,111,704
Energji e blerë (nga koncesionet)	159,040	142,374

KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE – KESH SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2010

(Shumat janë të shprehura në mijë Lek)

23. Flukset a parasë nga aktivitetet operative

	2010	2009
Fitim/Humbja para tatimit	17,098,824	3,422,676
Rregullime per:		
–Amortizimin/zhvleresimet	782,056	766,174
– rimarrje nga rezervat	(15,908)	604,875
– te ardhura nga grantet	(5,938)	(5,792)
– Te ardhura nga interesat (Shenimi 20)	(521,135)	(957,287)
– shpenzime interesi (Shenimi 20)	2,009,474	2,282,699
– fitim/humbje nga shkembimet valutore	1,039,071	3,118,390
– tatim mbi fitimin	(1,795,544)	(76,620)
Ndryshimet ne Kapitalin qarkullues		
– inventare	128,540	(1,795,557)
– llogarite e arketueshme dhe te tjera	(5,148,045)	(4,904,873)
– llogari te pagueshme dhe te tjera	(664,446)	(1,600,323)
– mjete monetare te ngurtesuara	20,223	430,511
Fluksi i Parase nga aktiviteti operativ	12,927,170	1,285,411

24. Angazhime

Angazhime ne qerane operative – kur një nga Shoqëritë e Grupit është qiramarrëse

Grupi merr me qira zyra dhe magazina të ndryshme me marrëveshje të pa-anulueshme qiraje të zakonshme. Qiratë kanë afate të ndryshueshme, klauzola të përshkallëzimit të çmimeve dhe të drejta ri-përtëritjeje. Grupi nënshkruan kryesisht kontrata një-vjeçare të ripërtërishte qiraje.

25. Ngjarje pas datës së bilancit

Në zbatim të shkresës së Ministrit të METE-es Nr.9366/1 date 08.02.2011 “Mbi zbatimin e VKM Nr. 33 datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave” dhe shkresës Nr.1269/1 date 09.03.2011 (Për përgatitjen e raportit për sistemimin e Kapitalit të regjistruar të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare) është paraqitur raporti i eksperteve kontabël në datë 30.04.2011 dhe pritët miratimi i raportit të ekspertit kontabël për zmadhimin e Kapitalit themeltar të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare.

Nga raporti përcaktohet rezultati i kapitalit themeltar të nënshkruar nga 1,551,778 mijë lekë bëhet 5,982,862 mijë lekë e barabartë me 5,982,862 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion të cilat zotërohen nga aksioneri i vetëm Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Për këto veprime nuk është kryer ende regjistrimi në kontabilitet dhe pritët të bëhet miratimi nga pronari (METE) për vazhdimin e procedurave të mëtejshme të pasqyrimin në organet përkatëse.